



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



KUVENDI KOMUNAL PEJË

I. Numër: 400-01/76387, datë: 27 Shtator 2024.

Në bazë të nenit 12.pika 2 (d), të Ligjit Nr.03/L – 040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës datë: 04.Qershor 2008 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 datë: 04.Qershor 2008) nenit 20 paragrafi 1, pika 1.4. dhe nenit 84. paragrafi 1, pika 1.4. të Statutit të Komunes së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë: 30. Shtator 2020, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 27 Shtator 2024, pas shqyrtimit të Draft –Planit të Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, 2024-2026, në Komunën e Pejës, merr:

VENDIM

Nr. 56/2024

Mbi miratimin në parim për dhënien në diskutim publik të Draft –Planit të Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, 2024-2026

- I. IPET në Diskutim Publik: Draft –Planit të Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, 2024-2026.
- II. Diskutimi Publik zgjat 14 ditë, nga dita e shpalljes – paraqitjes së Draft –Planit të Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, 2024-2026 në Tabelen e shpalljeve publike dhe në Ueb faqen zyrtare të Komunës së Pejës.
- III. Qytetarët e interesuar mund të njoftohen me tekstin – përmbajtjen e Draft – Planit të lartë cekur, përmes Drejtorisë Komunale për Arsim (DKA) të Komunës së Pejës.
- IV. Vërejtjet dhe sugjerimet eventuale në Draft –Planit të Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, 2024-2026, mund të bëhen me shkrim dhe të dorëzohen përmes Zyrës së pranimit – Arkives, për DKA të Komunës së Pejës, si dhe në Platformën e Konsultimeve Publike.
- V. Vërejtjet dhe sugjerimet duhet të paraqiten vetëm me shkrim dhe në kohën e afatit caktuar me këtë vendim, ngase vërejtjet e paraqitura jashtë afatit nuk do të mirrën parasysh.

Vendimi ti dërgohet:

1x1. DKA,
1x1. Arkivë.

